



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 42/8 prot.

Tiranë, më 12.03.2025

REKOMANDIM

Nr. 07, datë 12.03.2025

PËR KONTROLLUESIN “UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS”

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “Universiteti Bujqësor i Tiranës”, (në vijim, “Kontrolluesi”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 5, datë 09.01.2025 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit me objekt:

- *Zbatim i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi).*

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. “Universiteti Bujqësor i Tiranës” është institucion publik i arsimit të lartë që ushtron veprimtari mësimore, kërkimore-shkencore dhe administrative, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe VKM nr. 750, datë 05.09.2013 “Për

miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në përgjegjësi administrimi Universitetit Bujqësor të Tiranës”.

Kontrolluesi në kuadër të veprimtarisë që ushtron, përpunon të dhëna personale për kategoritë “studentë”; “staf akademik”; “staf administrativ”, etj. Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Kontrolluesi grumbullon në arkivin fizik dokumentacionin për stafin akademik të larguar që prej periudhës së krimit të institucionit. Konstatohet se në dosjet e personelit të larguar ruhen kopje të CV, certifikatë, mjet identifikimi etj.,

Nga analizimi i Rregullores së Brendshme të Kontrolluesit, si dhe të dokumentacionit të vendosur në dispozicion, në cilësinë e provës materiale, rezulton se Kontrolluesi nuk ka parashikuar afate konkrete lidhur me kohën e ruajtjes së të dhënave personale, për dokumentacionin që administron në funksion të veprimtarisë që ushtron. Të dhënat e mbledhura nga Kontrolluesi ruhen, pa përcaktuar një afat konkret të ruajtjes së tyre, në kundërshtim me germën “d” të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se, lidhur me kategoritë e të dhënave të grumbulluara, në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tij, Kontrolluesi duhet të parashikojë mbajtjen e të dhënave personale të grumbulluara në atë formë, që lejon identifikimin për një kohë të caktuar, por jo më tepër se sa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin për të cilin të dhënat janë grumbulluar. Koha e ruajtjes së të dhënave personale duhet të përcaktohet nga Kontrolluesi, në përputhje me parashikimin e germës “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit.

3. Konstatohet se Kontrolluesi disponon rubrikën “Politikat e Privatësisë” në faqen zyrtare të internetit <https://www.ubt.edu.al/> . Por nga shqyrtimi i përmbajtjes së saj rezulton se kur klikohet në këtë rubrikë, faja automatikisht të drejton në rubrikën “Politikat e privatësisë” në faqen zyrtare të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale <https://idp.al/politikat-e-privatesise/>.

Sa më sipër, subjektet e të dhënave nuk informohen mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t’i përpunojë të dhënat, afatin e mbajtjes së të dhënave, masat e sigurisë, të drejtat që subjektet e të dhënave gëzojnë (për akses, korrigjim dhe fshirje), etj, në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale është i rëndësishëm, pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë, si dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërmbushja e këtij detyrimi nga Kontrolluesi mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave. Informimi sipas

përcaktimeve të nenit 18 të Ligjit, duhet të aplikohet për çdo proces përpunimi të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, që kryen Kontrolluesi.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale pavarësisht faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë elektronike apo manuale, dhe pavarësisht faktit nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet faqes zyrtare të internetit, ka detyrim që të publikojë *“Politikën e Privatësisë”* dhe të informojë qartësisht subjektet e të dhënave, pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash me kontrolluesin realizohet nëpërmjet faqes së internetit.

4. Kontrolluesi disponon një sistem video-survejsimi CCTV për mbikëqyrjen e ambienteve të brendshme dhe të jashtme të universitetit. Konstatohet se Kontrolluesi disponon tabelë informuese mbi prezencën e sistemit të video-survejsimit, por nuk është sipas modelit standard të miratuar nga Komisioneri, në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 3 datë 05.03.2010 të Komisionerit *“Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejsimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”* i ndryshuar (në vijim, *“Udhëzimi nr. 3”*).

Sa më sipër, Kontrolluesi nuk informon qartësisht subjektet mbi përpunimin e të dhënave imazhe-video, nëpërmjet sistemit të video-survejsimit (CCTV), në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale mbi prezencën e sistemit të video-survejsimit (CCTV) është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale, të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë.

5. Konstatohet se, Kontrolluesi ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Rrjetin Akademik Shqiptar (në vijim, *“RASH”*) *“Për shërbimet e ofruara dhe të përfituara në fushën e teknologjisë së informacionit”*, me objekt ofrimin dhe implementimin e programeve më të përparuara software në fushën e arsimit të lartë (Pitagora + rrjet) të ofruara nga RASH dhe të përfituara nga UBT.

Referuar nenit 5, pika 4 të marrëveshjes UBT autorizon një person kontakti në pozicionin e Administratorit të sistemit PITAGORA.

Sistemi PITAGORA, popullohet me kategoritë e të dhënave të studentëve, përkatësisht: *“Emri”, “Atësia”, “Mbiemri”, “Datëlindja”, “Vendlindja”, “Nënshtetësia”, “Gjinia”, “Gjendja civile”, “Kodi i Studentit”, “Adresa e Vendbanimit”, “Numri personal”, “Numri i telefonit”, “Adresa e e-mail”, “Programi”, “Viti akademik”, “Gjendja e studentit”* etj. Modulet përkatëse me kategoritë e të dhënave, plotësohen përmes hedhjes manuale të të dhënave nga sekretaria mësimore.

Nga analizimi i përmbajtjes së marrëveshjes konstatohet se në të, nuk specifikohen masat konkrete teknike-organizative të detyrueshme për t'u zbatuar nga ana e përpunuesit, me qëllim garantimin e sigurisë dhe përpunimit të ligjshëm të të dhënave personale, si dhe nuk janë reflektuar detyrimet sipas parashikimeve në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr.

19 të Komisionerit, datë 03.08.2012 *“Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimit të një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”* i ndryshuar (në vijim, *“Udhëzimi nr. 19”*).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave palët duhet të miratojnë një kontratë, me anë të së cilës, të garantojnë përcaktimin e rregullave në marrëdhënien e kontrolluesit me përpunuesin, me qëllim që delegimi i përpunimit të këtyre të dhënave të përpunuesit, të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi, në mënyrë që të sigurohet që përpunuesi të garantojë përpunim të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave.

Sipas përcaktimeve të Udhëzimit të sipërcituar, çdo kontratë përpunimi (outsourcing), që ka për qëllim përpunimin e të dhënave personale, duhet të përmbajë dispozita konkrete që vendosin rregulla për përpunimin e të dhënave personale, sipas legjislacionit shqiptar. Çdo kontratë e tillë, duhet të parashikojë çdo masë që merr përpunuesi për të siguruar mbrojtjen e mjaftueshme të të dhënave, si dhe hapat që do të ndërmerren në rast cenimi të të dhënave.

6. Kontrolluesi disponon rregullore *“Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”* nr. 232 prot., datë 03.02.2017, por nga shqyrtimi i përmbajtjes së saj rezulton se, rregullorja i referohet modelit “tip” të publikuar në faqen zyrtare të Zyrës së Komisionerit. Konstatohet se, përmbajta e rregullores është e kufizuar dhe nuk reflekton detyrimet ligjore, sipas kategorive specifike të të dhënave personale që përpunon.

Kontrolluesi, nuk parashikon proceset, procedurat, masat teknike dhe organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të Kontrolluesit

Zyra e Komisionerit vlerëson se, hartimi i një rregulloreje specifike *“Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura teknike - organizative mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, (për çdo kategori subjektsh), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të

nenit 27 të Ligjit, duke mundësuar shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

7. Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Grupi i kontrollit konstaton mosplotësim të detyrimeve në lidhje me ngritjen, administrimin dhe Mirëmbajtjen e Sistemit të Menaxhimit së Sigurisë së Informacionit (SMSI) lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, të

parashikuara nga Udhëzimi nr. 47, datë 14.09.2018 *“Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”*, (në vijim, *“Udhëzimi nr.47”*).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Kontrolluesi, është i detyruar të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë SMSI në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 47.

Gjithashtu, sipas parashikimeve të Kreut IV, të Udhëzimit nr. 47, Kontrolluesi duhet të marrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, bazuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Ky është një detyrim i vazhdueshëm i Kontrolluesit që personeli i subjektit përpunues të të dhënave personale të trajnohet rregullisht për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është vendosur në dispozicion Kontrolluesit nëpërmjet rrugës postare.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit, gjatë seancës dëgjimore më datë 06.03.2025, organizuar nga Zyra e Komisionerit ka deklaruar angazhimin për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara gjatë hetimit administrativ të ushtruar, si dhe ka depozituar me shkresën nr. 42/7 prot., datë 06.03.2025, dokumentacion plotësues mbi konstatimet e procesverbalit të hetimit administrativ, si vijon:

- Printscreen i tabelës informuese mbi prezencën e sistemit të video-survejimit;
- Listë me afate për ruajtjen e dokumentacionit që administrojnë në kuadër të veprimtarisë që ushtron.

8. Konstatohet se, nga printscreen i tabelës informuese mbi prezencën e sistemit të video-survejimit, tabela nuk është sipas modelit standard të miratuar nga Komisioneri, në

kundërshtim me nenin 18 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 3 datë 05.03.2010 të Komisionerit “Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video-survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera” i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 3”).

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit, gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, si dhe angazhimin e tij për të rikuperuar shkeljet e konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe shmang mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 5, 18, 20, 27, 29, 30, 31 (pika 1, germa “a/1”), si dhe 32 të ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi, të ketë në vëmendje përpunimin e të dhënave personale, në përputhje me dispozitat e parashikuara në Kreun II të Ligjit;
2. Kontrolluesi, të marrë masa për përcaktimin e afateve kohore për ruajtjen e të dhënave, për të gjitha proceset e përpunimit, në përputhje me germën “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit;
3. Kontrolluesi, të marrë masa për zbatimin e detyrimeve, në lidhje me informimin e plotë të subjekteve të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 18 të Ligjit;
4. Kontrolluesi, të marrë masa për të rishikuar marrëveshjet e bashkëpunimit me përpunuesit duke specifikuar detyrimet midis palëve, sipas dispozitave të parashikuara në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 19 të Komisionerit;
5. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të marrë masa për të rishikuar rregulloren specifike “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, duke parashikuar masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, për çdo kategori të dhënash dhe për çdo proces përpunimi, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj.;
6. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me trajnimin e punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale dhe krijimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale;

7. Në zbatim të pikës 1, të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve, si vijon:

- (i) vazhdimisht, detyrimet e përcaktuara në pikat 1 dhe 3 më sipër;
- (ii) brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikat 2, 4 dhe 5 më sipër;
- (iii) brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikën 6 më sipër;

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;

8. Kontrolluesi të njoftojë Zyrën e Komisionerit për masat e marra;

9. Në rast mospërmbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Zyra e Komisionerit vepron sipas pikës 2 të nenit 30 dhe nenit 39 të Ligjit, të cilët parashikojnë se në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Zyra e Komisionerit vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot, më 12.03.2025.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi